

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR ZGJERIM TË HAPËSIRËS SË VEPRIMTARISË PËR THËRMIM
DHE SEPERIM TË GURIT GËLQEROR**



Për Kompaninë : “Renelual Tahiri” SH.P.K
**Titulli i Projektit : Zgjerim i hapësirës së seperacionit për thërmim
dhe seperim të gurit gëlqeror**
Ngastra kadastrale : P-71813026-02379-0 dhe P-71813026-02180-0
Vendi i quajtur : BRIJA-BRIJA
Zona Kadastrale : Zhur
Komuna : Prizrenit
Aplikuesi i Projektit: “Renelual Tahiri” SH.P.K

Korrik, 2025

Aplikuesi:

“Renelual Tahiri” shpk

Adresa: Rruga Joni 92/2, Prizren

z. Refki Hoxha

Tel: +383 44 113 194

E-mail: renelulal_tahiri@hotmail.com

Hartuesi i raportit:

Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati

Eksperte e licencuar për VNM

Nr. Licencës së lëshuar nga MMPH:

70/17

Tel.: +383 49 655 661

E-mail: edonak88@hotmail.com

Investitori:

“Renelual Tahiri” shpk

_____ v.v

Hartuesi i Raportit:

Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati

_____ v.v

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	4
2. BAZA LIGJORE E PËRPILIMIT TË RAPORTIT TË VNM-së	5
2.1. Rregullativa Ligjore	6
a) Dokumentacioni normativ.....	6
b) Dokumentacioni teknik	7
2.2. Metodologjia e Punës.....	7
3.0. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT.....	8
3.1. Potencialet ekzistuese	8
3.2. Të dhëna teknike te aktivitetit.....	9
3.3. Pozita gjeografike e lokacionit.....	10
3.4. Popullata dhe Vendbanimet.....	15
3.5. Lidhjet e komunikacionit	15
3.5. Kushtet klimatike.....	16
3.6. Relievi.....	17
3.7. Hidrogjeologjia	17
3.8. Pedologjia	18
3.9. Ndërtimi gjeologjik lokacionit.....	18
3.10. Natyra dhe biodiversiteti.....	21
3.11. Bimësia dhe vegjetacioni.....	21
3.12. Bota shtazore – Fauna	21
3.13. Peizazhi	22
3.14. Dukshmëria	22
3.15. Ajri	22
3.16. Uji.....	23
4. PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE INFRASTRUKTURA.....	23
4.1. Objektivat dhe infrastruktura.....	23
4.2. Përshkrimi i procesit teknologjik të thërrmimit dhe seperimit.....	23
5. Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve të mundshme në mjedis	27
5.1 Ndikimet në ajër	28
5.2. Ndikimet në Tokë.....	28
□ Ndikime të ndryshme që vijnë nga mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik të makinat që përdoren në këtë aktivitet.	29
5.3. Ndikimet në Ujë	29
5.4. Ndikimi në Peizazh	30
5.5. Ndikimi në florë dhe faunë.....	30
5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	30
5.7. Zhurma	31
5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	31
6. MARRJA E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE.....	32
6.1. Masat e marrura për mbrojtjen e ajrit.....	32
6.2. Masat e marura për mbrojtjen e Tokës.....	35
6.3. Masat për mbrojtje nga zhurma	36
6.4. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	36
6.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë.....	37
6.6. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore	37
6.7. Menaxhimi i mbeturinave.....	38
7. MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	38
7.1. Monitorimi.....	38
7.2. Raportimi.....	38
8. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT	38
9. KONKLUZIONE.....	41
11. Shtojcat	42

1. HYRJE

Në kuadër të vazhdimit të funksionimit të mirëfillët të aktivitetit minerar përkatësisht thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror pronë e kompanisë **“Renelual Tahiri” shpk** dhe me kërkesën e pronarit z. Refki Hoxha është paraparë edhe hartimi i raportit mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, për tu pajisur kompania e lartëcekur me Pëlqim Mjedisor nga MMPHI. Kompania në fjalë posedon Pëlqim dhe Leje Mjedisore të lëshuara nga MMPHI, për thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në parcelat nr. **P-71813026-02381-0 dhe P-71813026-02382-0**, ndërsa tani si rezultat i rritjes së kërkesës për këtë produkt është shtruar nevoja për zgjerim të kapaciteteve me aktivitetit të njëjtë punues në një hapësirë më të madhe. Andaj, lokacioni ku planifikohet të bëhet zgjerimi i sipërfaqës së veprimtarisë së thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror ndodhet në vendin e quajtur BRIJA-BRIJA, përkatësisht në parcelat nr. **P-71813026-02379-0 dhe P-71813026-02380-0**; në zonën kadastrale Zhur, komuna Prizrenit.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis paraqet një dokument të nevojshëm dhe të domsodoshëm për paisjen e kompanisë/aktivitetit në fjalë me Pëlqim Mjedisor nga ana e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, i cili poashtu është i nevojshëm për marrjen e lejës mjedisore dhe licencave tjera përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Qëllimi i hartimit të raportit është evidentimi i të gjitha kushteve përreth në lokacionin ku bëhet planifikimi për zgjerimin e kapaciteteve dhe realizim të aktiviteve të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror, bazuar në faktin se në kohën moderne po bëhen intervenime të vazhdueshme në mjedisin natyror, duke ndikuar kështu në humbjen e balancës ekologjike natyrore. Bazuar në qëllimin paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky raport bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për t’u marrë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet eventuale negative të këtij aktiviteti. Ndaj është e nevojshme që shoqëria të ndërgjegjësohet për t’a mbajtur sa më pastër mjedisin ku jetojmë duke marrë masat e duhura për trajtimin e mbetjeve, zhurmës dhe emetimit të pluhurit të dëmshëm në atmosferë që gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve minerare, përkatësisht thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror.

Raporti paraqet në mënyrë transparente ndikimin në mjedis gjatë thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror, në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis për kompaninë **“Renelual Tahiri” shpk**, me seli në Zhur, komuna e Prizrenit, me pronar z. Refki Hoxha është hartuar, duke u bazuar në projektin kryesor, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit ku është duke u zhvilluar dhe ku është planifikuar të bëhet zgjerimi i aktivitetit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror si dhe dokumenteve tjera ekzistuese. Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-së për zgjerimin e sipërfaqës për thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror të kompanisë **“Renelual Tahiri” shpk** ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis gjerë në kufijtë e lejuar.

Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të merren për bazë, gjatë fazës së funksionimit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror dhe pas përfundimit të aktivitetit të punës së tij.

Pra, edhe njëherë theksohet se kompania e lartëcekur ka pëlqim mjedisor dhe leje mjedisore, por për shkak të zgjerimit të hapësirës për ushtrimin e aktivitetit dhe vendosjes së makineris për thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, kompania është e obliguar ti nënshtrohet edhe njëherë procedurave për marrjen e Pëlqimit Mjedisor, pastaj edhe të Lejes Mjedisore nga MMPHI.

2. BAZA LIGJORE E PËRPILIMIT TË RAPORTIT TË VNM-së

Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM-së) është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Ligji Nr. 08/L-181, i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM -së. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Ligji Nr. 08/L-181, ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur. Analiza përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti në mjedis gjatë funksionimit kontinuel të aktivitetit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror:

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative gjerë në kufijtë e lejuar.

2.1. Rregullativa Ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Me rastin e hartimit të raportit të VNM-së për kompaninë **“Renelual Tahiri” Sh.p.k.** e cila planifikon të bëjë zgjerimin e hapësirës së thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror janë marrë për bazë ligjet më të rëndësishme të aplikuara të cilat janë paraqitur si në vijim:

- Ligji për VNM Nr. 08/L-181
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për minierat dhe mineralet Nr. 03/L-163
- Ligji Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet.
- Ligji Nr. 03/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës.
- Ligji nr. 08/L-112 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/L-26 për tokën bujqësore
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji Nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga ndotja nr. 08/L-025
- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012

Udhëzimit Administrative:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor.
- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palevizshme të ndotjes.
- Udhëzim administrative MMPH Nr. 04 /2018 për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme.
- Udhëzim administrative Nr.05/2011 për metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike si dhe masat për eliminimin e pasojave.
- Udhëzimi administrativ nr. 13/2013 për katalogun Shtetëror të mbeturinave.

b) Dokumentacioni teknik

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit
- Çertifikatat mbi të drejtat e pronës
- Kopjet e planit të ngastrërave
- Plani i situacionit
- Pëlqim/njoftim komunal mbi lejimin e aktivitetit

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar dhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse siç është direktiva e VNM-së.

2.2. Metodologjia e Punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për projektin e zgjerimit të hapësirës së thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror, bëhet në disa faza.

a) Informatat themelore, që nënkupton identifikimet siç janë:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis,
- Popullata ekzistuese me karakteristikat demografike,
- Karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacion,
- Klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
- Kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,
- Bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar,

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve:

- Madhësia dhe lloji i ndotjës
- Karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- Gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- Vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse

c) Analiza e rrezikimit të

- Njeriut
- Vlerave materiale
- Vlerave natyrore

d) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku planifikon të realizohet projekti i zgjerimit të hapësirës së thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror.

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kuantifikimit dhe vlerësimin të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me ndonjë potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

3.0. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Për hartimin e një raporti të vlerësimin të ndikimit në mjedis bazë kryesore e tij janë karakteristikat themelore të mjedisit në të cilin do të zhvillohet aktiviteti të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren.

Për t'u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

3.1. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyçe të hulumtimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të projektit për zgjerim të hapësirës së thërrmimit dhe

seperimit të gurit gëlqeror me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësit e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre. Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror siç janë toka, uji, ajri, reliefi, flora dhe fauna. Çdonjëri nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esence kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit. Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme është paraqitur në figurën nr.1.




Fig. 1. Raportet themelore ndërmjet faktorëve natyrorë dhe potencialeve ekologjike.

Në bazë të raporteve të paraqitura në figurën 1 është e qartë që faktorët natyror formojnë disa potenciale natyrore karakteristikat funksionale të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të projektit të zgjerimit të hapësirës thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror në zonën kadastrale Zhur komuna e Prizrenit.

3.2. Të dhëna teknike të aktivitetit

Investitori për realizimin e këtij projekti do të pajiset me të gjitha miratimet përkatës të lejeve të nevojshme për lejimin e projektit të zgjerimit të hapësirës për aktivitetin e

thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror. Pronësia e truallit për realizimin e këtij projekti është një pjesë pronë private e kompanisë **“Renelual Tahiri” shpk. dhe në bashkë Posedim të z. Refki Hoxha, Ali Hoxha, Nebi Hoxha dhe Lulzim Hoxha njëherit edhe bashkëpronar të biznesit “Renelual Tahiri” shpk.**

3.3. Pozita gjeografike e lokacionit

Lokacioni ku planifikohet të bëhet zgjerimi i sipërfaqës për zhvillimin e aktivitetit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror ndodhet në anën lindore të fshatit Zhur komuna e Prizrenit, fshati shtrihet në veri-perëndim të Prizrenit në distancë jo të largët nga Prizreni në anën e majtë të rrugës Prizren - Kukës në një distancë afërsisht 8 km nga Prizreni dhe vendburimi gjendet në anën e majtë të rrugës Prizren - Zhur - Kukës, dhe në anën e majtë të rrugës Dragash-Zhur nga aspekti administrativ i takon Komunës së Prizrenit, përfshihet në vendin e quajtur BRIJA-BRIJA, në parcelat nr. P-71813026-02379-0 dhe 02380-0, me sipërfaqe totale prej 6052 m², në zonën kadastrale Zhur, komuna Prizrenit. Toka në të cilën planifikohet të bëhet zgjerimi i hapësirës së zhvillimit të aktivitetit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror është me destinim Tokë Bujqësore, shfrytëzimi aktual Kullosë e klasës 6, ndërsa parcela nr. 02380-0 është tokë me destinim tokë Bujqësore, shfrytëzimi aktual Livadh i klasës 8. Parcelat e lartëcekura janë pronë private e kompanisë **“Renelual Tahiri” shpk, dhe në bashkë posedim të z. Refki Hoxha, Ali Hoxha, Nebi Hoxha dhe Lulzim Hoxha njëherit edhe bashkëpronar të biznesit “Renelual Tahiri” shpk.** Në bazë të të gjitha analizave është sajuar mundësia për vlerësimin e përgjithshëm të gjendjes ekzistuese të mjedisit jetësor si dhe ndikimeve të mundshme negative gjatë zhvillimit të aktivitetit, nga ky projekt. Këto vlerësime shërbejnë si bazë për kuantifikimin e ndikimeve të mundshme negative dhe për përcaktimin e masave të nevojshme mbrojtëse duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me zgjerimin e sipërfaqeve thërrmuese dhe seperuese të gurit gëlqeror.

Terreni është i pjerrët, kryesisht kodrinor malor, në afërsi direkte ku është duke u kryer aktiviteti i thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror. Pra, parcelat në fjalë ku planifikon të zgjerohet kompania janë të ngjitur në pjesën jug-përendimore me parcelat të cilat aktualisht kompania është duke i shfrytëzuar për thërrmim dhe

seperim të gurit gëlqeror dhe me qasje direkte në rrugën kryesore përkatësisht në rrugën që të lidh me fshatin Zhur dhe fshatërat tjerë të kësaj ane. Lokacionin në fjalë nga shtëpit e para të banimit ka një distancë prej rreth 350 metra, ndërsa nga qyteti i Prizrenit ka një distancë mbi 8 kilometra. Pozita gjeografike e kësaj zonë është kryesisht kodrinore, ndërsa në vendin ku është e vendosur kompania në fjalë parcela është e pjerrët, por investitori e ka rrafshur këtë sipërfaqe sipas nevojave të kompanisë dhe parcela/sipërfaqja manipuluese aktualisht është shëndrruar në një sipërfaqe të rrafshët.

Zona ku ndodhet aktiviteti i thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror ndodhet në lartësi 1,5 kilometra të fshatit Zhur, ndërsa me fshatin Posilishte ka një distancë rreth 2 kilometra, në drejtim jug-përendim, në largësi rreth 2 km (vijë ajërore) nga fshati Shkozë, ndërsa në pjesën përendimore të kësaj parcele kalon edhe Autostrada “Ibrahim Rugova” në një distancë largësie poashtu rreth 2 kilometrave.

Lokacioni i gurëthyesit në parcelat nr. 02381-0 dhe 02382-0 është lejuar me vendimin e organit të komunes së Prizrenit poashtu është i pajisur me Pëlqim dhe Leje mjedisore nga MMPHI.

Në afërsi të drejtëpërdrejt me impiantitin e thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nuk gjenden objekte të banimit, objektet e banimit me të afërta fillojnë të jenë në largësi mbi 350 m, ndërsa në afërsi të drejtëpërdrejt me lokacionin janë edhe dy punishte ku kryhet aktiviteti i njëjtë i eksploatimit dhe thërrmimit të gurit gëlqeror. Rruga e cila e lidhë qytetin e Prizrenit me fshatin Zhur-Dragash ndodhet në një distancë rreth 50m. Në këtë zonë ka edhe objekte tjera afariste me veprimtari të ngjashme gurëthyes dhe të ndryshme si restorante, hotele, markete, etj.

Në bazë të rezervave të gurit gëlqeror dhe bazuar në pozitën gjeografike të lokacionit, mund të themi se në këtë lokacion ekzistojnë kushte të mira për shfrytëzimin e gurit gëlqeror. **Kompania në fjalë gurin gëlqeror e merr nga sipërfaqja eksploatuese e cila ndodhet rreth 400 metra mbi impiantin për thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror.** Në vijim po e paraqesim pjesën e hartës satelitore ku shihet lokacioni i kompanisë “Renelual Tahiri” sh.p.k. në Zhur komuna e Prizrenit, me aktivitet thërrmimit dhe seperimin e gurit gëlqeror.



Fig. 2. Pamja satelitore e lokacionit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror.




Fig. 3. Situacioni i terrenit nga gjeodeti i licencuar

Më poshtë janë të bashkangjitura fotografi nga tereni dhe parcelat se ku është bërë planifikimi i realizimit të këtij projekti.

Foto nga lokacioni:



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale



RENELUAL TAHIRI

RENELUAL TAHIRI SHPK

**Leje për aktivitete të veçanta
SORTUES**

Emri i biznesit:	RENELUAL TAHIRI SH.P.K.
Nr. i regjistrimit:	1177
Nr. i licencës:	835/KPM/2022
Kohë zgjatja:	25/09/2025
Nr. Licencës:	810610099
Vendi:	Zharrë
Regjioni:	PRIZREN

RREGULLAT NË VENDPUNISHTE



NDALOHET
HYRJA E
PA AUTORIZUAR



RREZIKU NGA
NGARKESA



NDALOHET
LEVIZJA E
PA AUTORIZUAR



NDALOHET
ZJARRI



NDALOHET
HUDHJA E
MBETURINAVE



KUJDES
PUNOHET



KUJDES
TENSIONI
I LARTË



KUJDES
NGA
NGARGESAT



KUJDES
ZËRI I
LARTË



KUJDES
MAKINERI
E RENDË



KUJDES
PUNETORI



KUJDES
PENGESA



KËPUÇË
PUNE



VENDOS
MBROJTËSE
NGA ZHURMA



VENDOS
SYZET
MBROJTËSE



UNIFORMA
E PUNES



VENDOS
HELMETËN
MBROJTËSE



MBAJ MASKË
MBROJTËSE



VENDOS
DORËZAT

NDIHMË E SHPEJTË

194

POLICIA

192 112

ZJARRFIKËSAT

193

14

3.4. Popullata dhe Vendbanimet

Njëra nga veçorit qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis është edhe dendësia e popullatës dhe popullata. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë para se gjithash për shkak të nevojës që të hulumtohen hollësisht ndikimet e mundshme negative në banorët që jetojnë në hapësirën e analizuar. Komuna e Prizrenit përfshin një sipërfaqe prej 640 km² (5.94 % të territorit të Kosovës) posedon 76 vendbanime me 220.776 banorë nga të cilët në Prizren jetojnë rreth 110.000 banorë.

Kjo pozitë krijon të gjitha parakushtet për zhvillimin e kulturave bujqësore, blegtorisë, industrisë ushqimore dhe të turizmit në bazë të modelit të Austrisë, Sllovenisë, Zvicrës. Përmes anës së Prizrenit kalon rruga më e shkurtër që bashkon pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik me detin Adriatik. Kjo rrugë, për arsye politike nga e kaluara sot nuk ka rëndësi aq të madhe, është një rast i mirë që me valorizimin e saj të shfrytëzohen të gjitha përparsit e saj, duke marrë parasysh që në të kaluarën ka pas ndikim primar në zhvillimin e Prizrenit. Kushtet hidrologjike dhe kushtet natyrore të komunës së Prizrenit ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë dhe për zhvillimin e aktiviteteve turistike dhe rekreative.

E gjithë kjo ka ndikim në strukturën ekonomike të Prizrenit. Prandaj bujqësia dhe turizmi merret si pjesë madhore e aktiviteteve ekonomike në komunën e Prizrenit. Lokacioni ku do të vendoset deponia për grumbullimin dhe riciklimin e mbeturinave inerte, është e larguar mbi 500 m nga objektet banuese më të afërta, kështu që në pikëpamje mjedisore, duke pasur parasysh pozitën gjeografike të lokacionit ku do të realizohet projekti, nuk do të kenë ndonjë ndikim relevant në popullatë, përpos që do të kenë vetëm dobi sepse një numër i popullatës do të punësohen në këtë veprimtari është i lartë. Banorët e fshatrave për rreth lokacionit kryesisht merren me bujqësi, pemëtarë, blegtori dhe aktivitete të minerare.

3.5. Lidhjet e komunikacionit

Lidhjet e komunikacionit janë shumë të mira me të gjitha rrugët e komunes së Prizrenit. Zona e planifikuar për zgjerimin e sipërfaqës së aktivitetit të therrimit dhe seperimit të gurit gëlqeror, lidhet me rrugën magjistrale Prizren - Zhur - Dragash, përmes kësaj lidhet me magjistralen Prizren - Gjakovë, gjithashtu lidhet edhe me

rrugën autostraden Prizren - Prishtinë. Zona e hulumtuar në aspektin e infrastrukturës rrugore lidhet me tre qendra mjaft të rëndësishme të regjionit perëndimor të Kosovës. Pra, lidhet me Prizrenin, Dragashin, Gjakovën dhe Rahovecin. Rrjeti rrugor është i zhvilluar në shkallë të kënaqshme, rruga me e afërt e asfaltuar është rruga nga Prizreni – Zhur - Dragash që kufizohet me parcelen ku do të realizohet projekti i zgjerimit të sipërfaqes së tërrmimit dhe seperimit, gjithashtu edhe largësia me vendbanimet përreth është mjaft larg një distance nga Vendburimi prej 350 m.

Pra nga kjo që u cekë më lartë mund të konkludojme se zona karakterizohet me lidhje të mira komunikimi, të cilat lidhje në të ardhmen do të rritin edhe më shumë vlerën ekonomike të kësaj zone, nga arsyeja se me lehtësi mund të realizohen punimet dhe të behet përpunimi i materialeve të ndryshme të ndërtimit.

3.5. Kushtet klimatike

Klima e kësaj treve sipas pozitës së saj gjeografike, lartësisë mbi detare dhe sipas hulumtimeve meteorologjike siç janë: reshjet dhe temperaturat mesatare mujore dhe vjetore, është klimë kontinentale. Në viset e ulta për shkak të ndikimit të klimës mesdhetare dhe verave shumë të nxehta të korrurat janë ndër të parat në Evropën juglindore prandaj ekzistojnë përparësitë e pakrahasueshme për kulturat bujqësore: Hardhia e rrushit, pemët dhe perimet. Në viset malore, dominon klima e alpeve, për ç'arsye deri në Qershor nëpër gropa mbeten sasi të bores me ç'rast në mes të verës mund të zbardhohen majet e maleve.

Sa i përket reshjeve dhe temperaturave, Pranvera dhe Vjeshta karakterizohen përafërsisht me klimë të njëjtë. Të reshurat janë të formës riguese ose me karakter lokal. Temperatura mesatare sillet prej 11,5°C gjer në 12,5°C e si mesatare e këtyre merret temperatura prej 12,0°C. Temperaturat më të larta janë në muajin qershor 35,6°C, ndërsa në korrik 32,4°C dhe në gusht 31,1°C. Temperaturat më të ulta janë në muajin dhjetor, janar dhe shkurt. Temperaturat maksimale mesatare vjetore janë 22,5°C, ndërsa temperaturat mesatare minimale sillen prej - 0.5°C.

Regjimi i reshjeve në komunën e Prizrenit ka karakterin e klimës aride. Shuma e përgjithshme e reshjeve sillet nga 670 mm deri në 820 mm. Vlera mesatare vjetore e

lagështirës relative është 66.8%. Muaji më i thatë është gushti 66.2%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84.2 %.

Në komunën e Prizrenit erërat më të shpeshta janë ato veriore me 226% dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me 27%, kurse shpejtësia mesatare më e madhe e erës është 3.2 m/sek.

3.6. Relievi

Lokacioni më i gjerë ku ndodhet aktiviteti i therrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror pronë e kompanisë “Renelual Tahiri” shpik shtrihet ne terrenin kodrinorë - fushor me lartësi mesatare mbidetare prej 400-450 metra.

Pika me te ulëta janë ato që shtrihen për gjatë fushës (Rrugës) që është në anën Jug-Lindore te rajonit në fjalë, ndërsa pikat me te larta i ndërtojnë grebenet ne anën veri – lindore dhe VP të lokacionit në fjalë.

Relievi me lartësit, pjerrtësitë dhe ultësirat e ndryshme ndikon ne formimin dhe ndërtimin e elementeve klimatike, ne shfaqjen e të reshurave klimatike dhe formimin e rrjetit ujqor të cilat drenohen ne prrockat për rreth.

3.7. Hidrogjeologjia

Karakteristikat hidrogjeologjike të lokacionit janë të thjeshta. Morfologjia, ndërtimi gjeologjik, tektonika janë faktorët dominantë të cilët definojnë lëvizjen e ujërave sipërfaqësor dhe ato nën tokësor.

Ne aspektin hidrogjeologjik zona ku do të realizohet projekti përbehet nga shkëmbinj gëlqeror dhe rreshpe që janë të përshkueshëm nga ujërat.

Në pjesën e ngastrës ku planifikohet të realizohet ky projekt ujërat sipërfaqësore paraqiten vetëm gjatë të reshurave atmosferike, të cilat drenohen në kanalet natyrale (prrockat) dhe pastaj drenohen në lumin Bistrica e Prizrenit dhe me tutje nw afwrsi derdhet në lumin Drini i Bardhë, që njëherit paraqet edhe ujëmbledhësin kryesor në këtë rajon.

Në aspektin hidrologjik ujërat sipërfaqësorë të komunës së Prizrenit karakterizohen me ujera të bollshme sipërfaqësore të cilat drenohen në lumin Bistrica dhe Drini i Bardhë, por në bazë të shpimeve të puseve që janë bërë nga komuniteti për nevoja personale dhe informatave të marrura nga ta, thellësitë e ujërave nëntokësore janë

mesatare. Ujërat e lumit Bistrica e Prizrenit dhe të Drinit të Bardhë nevojiten për ujitjen e tokave që shtrihen afër shtratit të tij.

3.8. Pedologjia

Në aspektin pedologjik, tokat në afërsi të lokacionit ku planifikohet të realizohet projekti bëjnë pjesë në tokat e pazhvilluara, me një shtresë të materialit fushor karakteristik për gëlqerorët me ngjyrë të kafet jashtëzakonisht e cekët në masën e gëlqerorit edhe atë sillet deri 0.50 m. Kurse në largësi të ngastrave sidomos në ultësina (rrafshina) sipërfaqet ku janë të mbuluara nga tokat aluviale, deluviale janë toka me rentabilitet të lartë të kultivimit të kulturave bujqësore.

Kurse pjesët nga të cilat kemi një proces të alterimit të shkëmbinjve kemi toka që shumë pak shfrytëzohen tokë bujqësore, por ma tepër janë livadhore me vegjetacion të shumë të dobët të shkurreve dhe gjysmë shkurreve.

Harta pedologjike e rajonit të ngushtë, ku planifikohet të bëhet zgjerimi i aktivitetit të therrimit dhe seperimit të gurit gëlqeror është tokë ngjyrë e kafet të cekët, lagështinë e marrin nga ujërat atmosferik. pH është bazike sidomos në lokacionin në e gëlqerorit ku nga analizat kimike shihet se pH është 8 deri në neutrale, sepse nuk kemi materie të shkëmbinjve acidikë. Përbërje ma të madhe të tokave kemi me ngjyrë kafe e ma pak ato të smonicës. Tokat me ngjyrë kafe janë biologjikisht mjaft aktive të cilat kryesisht përdoren si toka bujqësore dhe pyje të dytat kalojnë në smonica dhe vështirë përdorën për bujqësi. Masivet shkëmbore në dhe rreth zonës janë kryesisht të rreshpeve sericitike dhe serpentinitet.

3.9. Ndërtimi gjeologjik lokacionit

Për gjatë gjithë shtrirjes së rajonit zhvillohet një gamë e gjerë depozitimesh, që fillojnë me ato të Triasikut e vijnë ekskluzivisht deri në Plio-kuaternar e Kuaternar. Depozitimet e Triasikut të Sipërm – Jures të Poshtme – Takohen në harkun Vermice-Vlashnje duke përfshirë edhe rajonet e Zhurit dhe rrugës nga Zhuri në Dragash, që i takojnë gjithashtu pjesës juglindore të planshetit, duke zënë rreth 15 % të sipërfaqes së rajonit.

Këto depozitime përfaqësohen nga ndërthurjet gëlqeroresh me shtrese të trashë të dolomitësh, i takojnë njësisë së Koritnikut dhe vendosen tektonikisht në trajte

mbihipje apo sharjazhi mbi depozitimet vullkano-sedimentare te njësisë se Vermice – Koxhi Ballkanit, qe përbën vazhdimin ne verilindje te njësisë se Gjeganit (Shqipëri). Elementet e shtruarjes në këto gëlqerorë nisur vetëm nga shtresëzimi pllakor e shtese trashë i tyre, jo gjithmonë janë te vërtetë dhe te besueshëm, me mirë është te përdoren ndërthurjet e holla ritmike te gëlqeroreve gri me ato me te bardha, te cilat takohen me rralle por janë me te besueshme. Trashësia e përgjithshme e tyre ne prerjet e plota është me e madhe se 800 m.

Mbi depozitimet karbonatike të Triasit te sipërm me kalime normale takohen dhe depozitimet silicore radiolaritike te konsideruara te Jures se sipërme me përhapje fragmentare ne rajonin e Reskut (20 km ne juglindje te qytetit te Kukësit).

Prandaj, këto depozitime ne njësinë e Gjallicës janë konsideruar si te Trasikut te sipërm - Jurasikut te poshtëm dhe ne këtëpërcaktim e kemi ruajtur dhe për përhapjen e tyre ne planshetin e Prizrenit megjithëse këtu silicoret radiolaritike te Jures se poshtme nuk janë takuar.

Depozitimet e Jures- Kane përhapje te kufizuar, ne trajte fragmentare, por qe krijojnë një vijueshmëri te qëndrueshme nga JP drejte VL dhe takohen ne rajonin Vermice – Vlashnje – Nashec apo ne krahun e majte te rrjedhjes se Drinit te Bardhe, duke u mbuluar ne jug tektonikisht nga gëlqeroret e Triasikut te sipërm dhe ne veri transgresivisht nga gëlqeroret e strukturës karbonatike kretake te Pashtrikut.

Këto depozitime ne verilindje te përhapjes se tyre mbulohen nga depozitimet e Pliocenit dhe Kuaternarit për tu takuar përsëri ne verilindje te qytetit te Prizrenit ne formacionet jurasike te Koxha Ballkanit.

Këto depozitime përfaqësohen nga ndërthurje rreshpesh argjiloro-mergelore me ngjyre gri deri në të zezë, rreshpesh argjiloro-silicore, rreshpesh muskovitike, mikashistesh kuarcore, rreshpesh amfibol-klorit-sericitike, rreshpesh argjilo-ranorike me ngjyre te verdhe, me olistolite gëlqerorësh (T3), dhe derdhje vullkanitesh si një kompleks i përbashket vullkano-sedimentar i cili shërben si poshteshtroje tektonike per gëlqeroret e Triasikut te sipërm, që mbivendosen tektonikisht nga lindja dhe ofioliteve te Mirdite-Gjakoves qe mbi vendosen tektonikisht ne perendim.

Depozitimet Kretakut - Përfaqësohen nga gëlqerore te strukture karbonatike te Pashtrikut, te cilet vendosen transgresivisht mbi formacionet me te vjetra, Triasike e Jurasike. Ne fushe perhapjen e ketij formacioni sedimentar, nga studjuesit e

meparshem (Menkoviç Y, Karoviç J, Kosçaj M., 1981), per planshetin e Prizrenit janë dokumentuar katet Cenomanian, Turonian dhe Senonian.

Përhapjen me te madhe sipërfaqësore te depozitimeve kretake e kane depozitimet e kretes se sipërme apo te Cenomanianit, te cilat ndertojne nivelet e poshtme e te mesme te prerjes se strukturës se Pashtrikut. Ne nivelet e poshtme te tyre ato perfaqesohen nga gelqeroret konglomeratik dhe konglomeratet, me sipër kalohet ne gelqeroret biomorf shtrese holle dhe shtrese trasha (bankovit) kriptokristalore me faune. Gelqeroret kryesisht janë të ndërtuar nga materiali karbonatike kriptokristalore (me CaCO_3 60 - 80 %) dhe komponente pelitomorfe argjilore. Gëlqeroret e Turonit kanë përhapje me te vogël ne kuader te Kretakut te siperm. Takohen ne shpatet (pjerresite) e Pashtrikut, ku me kalime normale e te doradoreshme, ato zhvillohen mbi gëlqeroret e Cenomanianit. Shfaqen ne forme nderthurjesh shtresash te holla dhe te trasha (bankovit), te sedimentuar ne kushte te njëjta me ato te Cenomanianit.

Depozitimet e Senonianit gradualisht dhe shkallë-shkalle vijojnë mbi ato te Turonianit dhe jane te perhapura ne lartesite e majes se Pashtrikut, por edhe rreth fshatrave Mazrek, Zym dhe Dedaj ne pjesen verilindore te strukture, per shkak te zhytjes se kesaj strukture ne kete drejtim.

Plioceni - Sedimentet e ujërave të embla të pliocenit, përfaqsojnë pjesën e skajshme të basenit të Dukagjinit. Në këtë hapësirë janë konstatuar sedimentet liqenore, të cilat janë formuar sipas të gjitha gjasave në fillim të miocenit. Prezenca e sedimenteve të miocenit, si dhe sedimentet e katit pontian në ultësiren e Prizrenit, në pjesën jugore, tregojnë se kjo pjesë e basenit të Dukagjinit, ka qenë i përbytur nga liqeni dhe ate kryesisht pas pontianit.

Për shkak të kësaj në Plansheten e Prizrenit janë veçuar dhe treguar sedimentet e pliocenit të sipërm, gjegjësisht ekvivalentet e katit dakian dhe levantian.

Sedimentet e pliocenti të sipërm (P2,3) - Sedimentet e ujërave të embla të pliocenit të sipërm janë të zhvilluara në pjeset jugore të basenit të Dukagjinit, respektivisht në ultësiren e Prizrenit, ku në pjesen më të madhe janë të mbuluara me sedimente të kuaternarit.

Këto sedimente të pliocenit të sipërm më së miri janë të zbuluara në pellgun e lumit Doshlica te fshati Damian, si dhe në rrethinën e Krushës së Madhe, Randobravës,

Trnjë, Landovicë dhe Grazhdenik. Përfaqësohen nga rërat, rërat argjilore, alevrolitet, argjilat dhe zhavorret.

Sedimentet e pliocenit në ultësirën e Prizrenit, pjesën më të madhe e përbëjnë sedimentet horizontale, treshësia e të cilave vlerësohet të jetë rreth 350 m.

Sedimentet liqenore të pliocenit janë veçuar nga Prizreni nëpër Poslishtë e deri në Zhur. Disa breznitë të vogla të izoluara janë takuar edhe në prerjet erozionale, në të dy anët e lumit Drini i Bardhë, nga fshati Nashec deri në fshatin Dobruzhdë. Vjetërsia e sedimenteve të pliocenit të sipërm është konstatuar në bazë të mikrofaunës dhe polenit.

3.10. Natyra dhe biodiversiteti

Në bazë të të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë teren kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është ndonjë zonë/territor që është potencial të futet nën mbrojtje. Ndërsa në një distancë edhe me të largët fillojnë bjeshkët e Sharrit të cilat janë zonë e mbrojtur me ligj. Por kompania me aktivitetin në fjalë, në asnjë mënyrë nuk i atakon zonën e mbrojtur.

3.11. Bimësia dhe vegjetacioni

Në bazë të shqyrtimeve vizuale të zonës ku planifikohet të bërë zgjerimi i sipërfaqes së thërmimit dhe seprimit të gurit gëlqeror kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ultë barishtore, manaferra, shkurre kurse në hapësirën më të gjera edhe shkozë, qarr, bung, etj.

Kemi hasur në këtë zonë edhe në bimët që u përshtaten kushteve të jetës së tyre në shkëmbinjtë gëlqeror.

Parcelat në fjalë nuk është e mbjellur me të lashta periodike, por është e mbuluar me kullota, barishte, shkurre dhe manaferra të ndryshme.

3.12. Bota shtazore – Fauna

Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike si dhe në bazë të të dhënave nga vendasit në këtë zonë përpos kafshëve dhe shpezëve shtëpiake, jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, iriqi etj. Prej brejtësve- minjtë, prej zvarranikëve: gjarpërinjtë, breshka e tokës, zhapini i gjelbër etj,

nga insektet: mizat, mushkonjat etj. Ndërsa prej shpezëve janë karakteristike: bilbilat, fëllënëzat e fushës, lejleku, shqiponja, etj.

3.13. Peizazhi

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin e realizimit të projektit-mjedisi. Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive.

Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit. Pamja e këtij regjioni është mjaft karakteristike, me pamje kodrinor-fushor-malor, dhe përrenjve karakteristik, si dhe hapësirat vegetative mjaft të bujshme.

3.14. Dukshmëria

Shikuar nga pozita e lokacionit ku planifikohet të realizohet projekti dukshmëria është mjaft e lartë në të gjitha anët e horizontit. Vendet që shtrihen në këtë lokalitet karakterizohen më megjulla dhe më lagështi të madhe të ajrit gjatë stinës së dimrit. Edhe kjo zonë nuk përjashton nga ky fenomen por në masë më të vogël, sepse nuk ka kurrfarë uzine e as diçka tjetër që e rritë ndotjen e ajrit dhe për rrjedhojë e zvogëlon dukshmërinë.

3.15. Ajri

Vegjetacioni i mirë, prania e madhe e llojeve të ndryshme të faunës janë treguesit kryesor për pastërtinë e ajrit. Kjo është zonë kryesisht bujqësore dhe blegtoriale, në afërsi ka një gurëthyes tjetër që do të shërbej edhe për riciklimin e materialit ndërtimor. Ndotja e ajrit përveç nga procesi i thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror, ndotja mund të ndodhë nga trafiku i cili zhvillohet në rrugën magjistrale Prizren - Zhur - Dragash. Mund të konkludojmë se pastërtia e ajrit në këtë regjion është në nivel të lakmueshëm

3.16. Uji

Në këte lokacion ku planifikohet të bëhet zgjerimi i aktivitetit të therrmit dhe seperimit të gurit gëlqeror, kualiteti i ujit është i nivelit të mirë sepse në afërsi të lokacionit nuk ka ndotës potencial. Ndotja e ujit posaçërisht shkaktohet nga eksploatimi i inerteve përreth dhe në lumin Drini i Bardhë, nga trafiku i cili zhvillohet në rrugën magjistrale Prizren – Zhur- Vermic apo Zhur-Dragash dhe nga shpërlërja e trasës së rrugës me të reshurat atmosferike. Ndotja e ujit pjesërisht shkaktohet edhe nga stacionet e karburanteve të cilat janë të vendosura nga dy anët e rrugës magjistrale dhe nga komuniteti të cilët bëjnë shkarkimin e ujërave të zeza përgjatë brigjeve të lumit Bistrica e Prizrenit dhe Drini i Bardhë.

4. PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE INFRASTRUKTURA

4.1. Objektivat dhe infrastruktura

Kompania “Renelual Tahiri” Sh.p.k. me nr. tw biznesit 810610099 me aktivitetin për therrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, është i regjistruar si biznes që nga viti 2004. Përshkrimi i saktë i impiantit për therrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ka disa objekte të ndarë sipas nevojës së shfrytëzimit, si në vijim: 1. Hyrja e makinerisë dhe puntoreve; 2. Zyrat e stafit dhe menaxherit; 3. Hapësira për vendosjen e makinerisë/thërrmojsës për therrmim dhe seperim; 4. Hapësira për klasifikimin të materialit të therrmuar; 5. Hapësirat për deponim të materialit të therrmuar; 6. Hapësira ku janë të vendosura linjat e coptimit apo imtësimit dhe përpunimit të materialit inert; 8. Hapësirat ku janë të vendosura linjat e peshimit dhe parkimit së makinave ngarkuese dhe transportuese.

4.2. Përshkrimi i procesit teknologjik të thërrmimit dhe seperimit

Përshkrimi i thërrmuesit me seperacion dhe pajimeve përcjellëse:

Kompania “Renelual Tahiri” Sh.p.k. e cila si aktivitet ka therrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në zonën kadastrale Zhur komuna e Prizrenit ka të vendosur thërrmuesen me seperacion që përbehet nga këto pajime: Thërrmuesja primare me nofulla mobile (vetëlëvizëse), me kapacitet të thërrmimit 80 m³/h, ka të bashkangjitur bunkerin pranues vëllim prej 30 m³, dozatorin me vibrim dhe transportuesit shiritor për bartje të materialit të thërrmuar, Thërrmuesja sekondare me traj (mulliri),

Seperacionin (sitën vibruese e pjerrtë) mobile (vetëlëvizëse), sitë vetëlëvizëse dimensionet e sitës 1530x4800mm, kapaciteti i sitjes gjerë në 150 m³/h, si dhe transportuesit shirior për transportimin e materialit të thërrmuar dhe të seperuar në deponit adekuate.

Pajisje tjera të cilat përdoren në këtë kompani janë:

Makinë ngarkuese 2 copë

Bager 2 copë

Kamion për transportim 5 copë

Cisterne për ujë 1 copë

Gjenarator 1 copë

Procesi teknologjik i thërrmuesit me seperacion;

Prodhimi në thërrmuesit me seperacion bëhet në bazë të kërkesave të blerësve, në bazë të cilave bëhet edhe plani i biznesit të kompanisë. Prodhimi në thërrmues me seperacion bazohet në prodhimin e fraksioneve për ndërtimin e rrugëve, për agregat betoni dhe agregat asfalti.

Në vijim po japim përshkrimin e procesit teknologjik të thërrmueses me seperacion:

Guri gëlqeror i shkëputur me anë të lëndëve plasëse, ngarkohet në ballë të kateve të punës me ekskavator dhe me kamion të cilët e bartim masën shkëmbore nga sipërfaqja e mihjës. Masa e ngarkuar transportohet me kamionë të veçantë për transportimin e masës shkëmbore. Gabaritet e masës së gurit gëlqeror të cilët ngarkohen në kamion nuk guxojnë të jenë më të mëdhenj se 900 x 710 mm.

Guri gëlqeror nga kamionët derdhet në bunkerin pranues (fortina) me kapacitet prej 30 m³ nr. 1, mandej me anë të dhënësit vibrues nr. 2, ushqehet thërrmuesja primare me nofulla nr. 4, e cila ka kapacitet teorik prej 60 m³ në orë, ose kapacitet real prej 30 deri 40m³ në orë. Transportuesi i pjerret shiritor nr. 3, shërben të mënjanoj sterilin nga masa e pastër, në këtë mënyrë bënë pastrimin e gurit gëlqeror që do të trajtohet në thërrmuesen me seperacion dhe të përgatis prodhimin për aplikim në ndërtimtari të ulët dhe të lartë.

Nga thërrmuesja primare nofulllore nr. 4, përmes dhënësit vibrues nr. 2 guri gëlqeror i thërrmuar kalon në transportuesit shiritor nr. 3a dhe nr.5, nga ku transportuesi shiritor nr. 3a fraksionin +0-31mm ose +0-60mm e dërgon në deponin adekuate, fraksioni i mbetur + 31mm ose + 60mm përmes transportuesit shiritor nr. 5 dërgohet

në thërrmuesen sekondare me çekiça nr. 6, që ka kapacitet teorik prej 60 m³ në orë, ose kapacitet real prej 40 m³/h, e cila e bën thërrmimin më të mirë të shkëmbit dhe e nxjerr madhësinë e nevojshme të fraksioneve për aplikim për prodhim të betonit dhe asfaltit. Thërrmimi i materialit në këtë thërrmuese bëhet sipas dëshirës nga se ka mundësi të rregullimit (për këtë operacion do të jetë e pajisur me mekanizëm të veçantë) prandaj edhe lehët nxirren fraksionet e dëshiruara.

Nga kjo thërrmuese me anë të transportuesit shiritor nr. 7, materiali transportohet në sitën vibruese nr.8, ku bëhet ndarja në fraksione sipas kërkesave të blerësve. Në sitë sigurisht se mbetet një sasi e cila kalon kufijtë e të kërkuarës (do me than se madhësia e një pjese të kokrrave të fraksionit është më e madhe se vrimat e sitës), prandaj kjo sasi e materialit do të kthehet përsëri me anë të transportuesit shiritor nr.13, në thërrmuesen sekondare numër 6, ku do të bihet në madhësi të fraksioneve të lejuara, dhe kështu e përgatitur s'bashku me materialin tjetër me transportier shiritor nr.7, kthehet në sitën vibruese nr. 8, për trajtim të dytë, e po që se ka nevojë (ajo në mënyrë kontinuele) do të kthehet edhe herëve tjera në thërrmuesen sekondare gjërë sa të fitohet madhësia e fraksioneve që do të kalojnë nëpër rrjeta të sitës. Materiali i trajtuar në sitën nr.8, me anë të transportuesve shiritor nr.9, nr.10, nr.11 dhe nr.12, transportohet në deponit nr. 14 të caktuara për fraksione adekuate.

Menaxhimi i procesit teknologjik bëhet nga dhoma afër thërrmueses e në të cilën është vendosur ormani me tërë automatiken dhe mbrojtësit për tërë hargjuesit e energjisë elektrike, si dhe pulti komandues i cili është i vendosur në ormanin adekuat të caktuar për te.

Automatika është e rregulluar në atë mënyrë që mundëson lëshuarjen në punë të pajimeve të gurthyesit me seperacion në mënyrë automatike dhe manuale. Në pultin komandues ekziston rregullatori komandues për zgjedhjen e punës së gurthyesit me seperacion.

Nëse zgjedhim punën automatike, atëherë për fillimin e startimit të pajimeve të gurthyesit me seperacion, pajimet lëshohen në punë automatikisht, duke filluar nga më të largëtat kah të afërmet, nga transportierët për fraksionet finale, pastaj sita vibruese, transportierin shiritor tjetër, gurthyesen me traj, transportierët shiritor, dhënësin vibrues, thërrmuesen nofulllore, transportierin shiritor dhe në fund dhënësin vibrues.

Te ndalesa e pajimeve të gurthyesit me seperacion në mënyrë automatike, pajimet ndalen me radhë në anën e kundërt të lëshimit të pajimeve duke filluar nga dhënësi vibrues e tutje. Te zgjedhja e punës në mënyrë manuale, pajimet lëshohen në punë secila në vete, përmes tastereve të veçanta, sipas zgjedhjes ton, gjithashtu edhe te komanda manuale duhet respektuar radhën, e lëshimit të pajimeve në punë, sikurse të mënyra automatike. Udhëheqja manuale preferohet vetëm në raste të defekteve, dhe në raste të remontit të pajimeve.

Pajimet në gurëthyes me seperacion aktivizohen me anë të energjisë elektrike ku pronari ka të ndërtuar trafon me mjete personale.

Për realizimin e procesit teknologjik pronari ka në disponim edhe këto mjete të ngarkimit dhe transportit: 3 kamionë me kapacitet 10m³, dy kamionë me kapacitet 20m³, dy ngarkues Ekskavator, dhe dy lopata ngarkuese.

Renditja dhe lidhshmëria e pajimeve dhe stabilimenteve në mes veti të cilat nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror shihet në skemën teknologjike të paraqitur ne shtojcën 1.

Komponentët hyrëse në Kompaninë “Renelual Tahiri” sh.p.k me aktivitet Thermim dhe Seperim i gurit gëlqeror janë:

- Energjia elektrike.
- Uji
- Nafta
- Guri gëlqeror

Karburantet si lëndë djegëse nafta shërbenë për furnizimin e automjeteve transportuese dhe ngarkuese. Energjia elektrike shërben për ndriçim dhe funksionim të pajisjeve si dhe për nxehje. Furnizimi me energji elektrike bëhet nga rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike, nëpër mes trafostacionit që është pronë e kompanisë. Uji shfrytëzohet për qëllime sanitare, për sperkatjen e siperfaqes operationale (gurthyes me seperacion), ujitjen e siperfaqeve te gjelbruara.



Nevojat e ujit për sanitari varet nga numri i punëtorëve p.sh për një punëtor nevojiten 25 lit. ujë/ditë. Furnizimi me ujë bëhet nga pusi i cili është nxjerr me shpim të thellë nga pronari i Kompanisë.

Komponentët dalëse në procesin e thermimit dhe seperimit te gurit gëlqeror janë:

- Avujt i hidrokarbureve dhe gazrat shkarkuese nga makinat transportuese.
- Karburantet djegëse të lëngëta nafta
- Ujërat e ndotura.
- Zhurma.
- Mbeturinat e ngurta.

S k e m a

E levizëjes së procesit teknologjik



Legjenda

1. Fortina (bunkeri) $V_b = 30m^3$
2. Dozator pllakor
3. Grilla për pastrimin e tamponit. Fr. 0-32mm
4. Shirit transportu es - Tampon L=18000 mm B= 600 mm Fr. 0-32mm
5. Thërmojs Sekondare K:E:G: 350-350mm. $Q_h = 110m^3/h$
6. Shirit transporëtu es L= 18000 mm B= 800mm 7. Sit vibruse 5 shkallëshe , për ndarjen e fraksioneve
8. Shirit transportu es L= 18000 mm B= 600mm Fr. 32-63mm 9. Shirit transportu es L= 18000 mm B= 600mm Fr. 16-32 mm 10. Shirit transportu es L= 18000 mm B= 600mm Fr. 8-16 mm 11. Shirit transportu es L= 18000 mm B= 600mm Fr. 4-8 mm 12. Shirit transportu es L= 18000 mm B= 600mm Fr. 0-4mm

5. Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve të mundshme në mjedis

5.1 Ndikimet në ajër

Nga aktiviteti i therrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror, si ndikim negativ në mjedis shprehet në ajër. Hartuesi i këtij raporti vlerëson se nga teknologjia e therrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror liron grimcat e mëdha të pluhurit të cilat tentojnë të gravitojnë për shkak të peshës së tyre në drejtim të tokës, dhe depozitohen në sipërfaqen operationale të lokacionit dhe më gjerë ku do të behet therrmimi dhe seperimi/selektimi i materialit të therrmuar, kurse pluhurat me përbërje të elementeve kimike që posedon vetë lënda minerale, thërmitë më të vogla të cilat i bartë ajri për shkak të reliefit dhe kushteve tjera mjedisore gravitojnë në distanca ma të largëta, kjo situatë e përshkruar, kishte me qenë pa përdorimin e masave për zvogëlimin e pluhurit. Ndotësit janë kryesisht pluhurat që barten me anë të erës, por duke iu falënderuar formës së relievit, konfiguracionit të terenit, ndërtimin e hapësirave të veqanta për grumbullimin e fraksioneve, largësinë si dhe pozitës së lokacionit ku është i vendosur impianti i therrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror, bartja e pluhurit me anë të erës nuk arrin deri te vendbanimet e banuara më të afërta.

Gjatë realizimit të procesit teknologjik për therrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror ndikime negative në ajër ndodhin edhe nga:

- Pluhuri i cili lirohet çdo herë gjatë zbrazjes së materialit kur vije në impiant për therrmim,
- Pluhuri gjatë copitimit dhe imtësimit të materialit (gurit gëlqeror).
- Pluhurat të cilët lirohen gjatë selektimit të materialeve të caktuara
- Pluhurat të cilët lirohen gjatë bartjes apo zhvendosjes së materialeve
- Pluhurat të cilët lirohen nga mekanizmi ngarkues në automjetet transportuese.
- Pluhurat të cilët lirohen nga rrugët jo të asfaltuara dhe sipërfaqet operationale që ndodhën në afërsi.
- Gazrat të cilat lirohen nga automjetet e ngarkimit dhe transportit.

5.2. Ndikimet në Tokë

Si ndikim negativ në tokë gjatë realizimit të procesit teknologjik të therrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror mund të shkaktohen nga:

- Deponimi i fraksioneve të pluhurit që vije kur sillet guri gëlqeror në “impiant”.

- Si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit teknologjik të therrimit dhe seperimit, mbeturinat e ndryshme kryesisht inorganike (dheu).
- Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga proceset teknologjike të cekura gjatë blurjes dhe imtësimit të materialit inert,
- Ndikimet nga ngjeshja e tokës të cilën e shkaktojnë makinat punuese.
- Ndikime negative nga korozionet që mund të ketë hekuri.
- Ndikime të ndryshme që vijnë nga mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik të makinat që përdoren në këtë aktivitet.

5.3. Ndikimet në Ujë

Ndikime negative në ujë gjatë realizimit të procesit teknologjik të therrimit dhe seperimit të gurit gëlqeror mund të shkaktohen:

- Nga ujërat e përdoruar për sperkatje gjatë procesit të therrimit-procesit të imtësimit.
- Ujërat që kontaktojnë materialin e imtesuar dhe pluhurat e deponuar.
- Nga derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat e lartëcekura të cilat me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike si dhe në ndotjen e ujërave nëntokësore.
- Nga derivatet dhe vajrat të cilat krijohen në oficinën e riparimit të mjeteve ngarkuese dhe transportuese, si dhe nga gjeneratori për prodhimin e energjisë elektrike, nëse ka.
- Nga vajrat dhe lubrifikantët e ndryshëm që derdhen nga pajimet dhe stabilimentet përpunuese si dhe nga mirëmbajtja dhe riparimi i tyre.
- Nga ujërat e reshjeve të cilat mund të kontaktojnë fraksionet e rrëres si dhe ujërat e zeza.
- Pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor, etj.

5.4. Ndikimi në Peizazh

Lokacioni ku do të zgjerohet impianti për therrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror me objektet përcjellëse, është afër disa gurëthyesve tjerë, e që i jep pamjen e një vendi industrial.

Peizazhi kuptohet që do të degradohet, por i cili me masat të cilat do të merren në mbarim të jetëgjatësisë së projektit, respektivisht pas kryerjes interesimit për ta ushtruar këtë aktivitet, peizazhit do ti kthehet pamja në harmoni me gjendjen e përafërt të mjedisit rrethues. Këto masa do të arrihen me aplikimin e rikultivimit si masë për kompensim të shfrytëzimit.

5.5. Ndikimi në florë dhe faunë

Për shkak të proceseve operuese që zhvillohen në aktivitetin e therrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror me objektet përcjellëse dhe në gjatësinë kohore të operimit të aktivitetit dhe në sipërfaqen operuese flora tërësisht do të shkatërrohet, e cila duhet të rikultivohet pas përfundimit të aktivitetit. Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se do të largohen nga regjioni i veprimtarisë prodhuese dhe do të zhvillohet në terrenin e përafërt që i përshtatet faunës.

5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Nga zhvillimi i aktivitetit therrmues dhe seperues në këtë lokalitet për shkak të pozitës dhe largësisë nga vendbanimet, siq e kemi cekur në pasuset e mëparme, nuk do të ketë nevojë të bëhet ç'vendosja e asnjë ndërtese banuese e as ndërtesave tjera ndihmëse.

Zhvillimi i veprimtarisë përpunuese në këtë lokalitet pak të zhvilluar, ka një rëndësi të veçantë për popullatën e këtij regjioni.

Pronari i kompanisë “Renelual Tahiri” Sh.p.k. për të zhvilluar veprimtarinë e vet duhet të punësoj një numër të punëtorëve, kryesisht nga popullata vendase.

Materiali i cili do të therrmohet do të jetë guri gëlqeror i cili nuk përmban materie të rrezikshme përpos pluhurit i cili mund të paraqet problem për shëndetin e njerëzve. Prandaj si u cek më lartë në aspektin e punësimit dhe zhvillimit ekonomik do të ketë ndikime pozitive.

5.7. Zhurma

Zhurma, si element në teknologjinë e therrimit dhe seperimit të gurit gëlqeror ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banuara por jo i papërfillshem.

Zhurma vjen si rezultat i aktivitetit të procesit teknologjik të coptimit/imtësimit, klasifikimit dhe deponit nga makinat, e gjithashtu gjatë procesit të ngarkimit, transportit, mirëpo për shkak të pajimeve teknologjike dhe atyre transportuese e ngarkuese që janë prodhime të mirëmbajtura niveli i zhurmës është nën kufijtë e lejuar me standarde.

Me shfrytëzimin e pajimeve prodhuese në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim është 90 dB.

Zhurma për zonën e banuar është plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës nuk kalon 50 dB, kurse gjatë natës nuk punohet. Pasqyrë tabelore e nivelit të zhurmës në varshmëri nga distanca jepet në vijim.

Zhurma	Distanca (m)			
	10	50	100	500
90 db -niveli Për pajisje moderne	59	45	39	25

5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Pasi që aktiviteti i therrimit dhe sepermimit të gurit gëlqeror dhe pajimet tjera përcjellëse do të jenë mirë të projektuara, të vendosura dhe të monitoruara nga ekspertët e lamive përkatëse dhe njëherit kur dihet se brenda veprimtarisë nuk kemi të bëjmë me materie të rrezikshme për mjedisin, dhe duke pasur parasysh kapacitetin e punës, aksidente mjedisore të mëdha nuk mund të ndodhin. Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo etapë të proceseve teknologjike në punishte si:

- Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese,
- Nga mekanizmi punues (mundësia e ndezjes),
- Nga mekanizmi punues mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik,
- Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë transportit të produkteve.

6. MARRJA E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE

6.1. Masat e marrura për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër të cilat i kemi cek më lart duhet ndërmarr këto masa: Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të therrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror duhet të mënjanohet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin. Meqëse kompania posedon thërmojsën që e përdor në gurëthyesin egzistues, për mënjanimin dhe zvogëlimin e sasisë së pluhurit kompania është e detyruar të bëjë instalimin e sistemit të ujit për zvogëlimin e sasisë së pluhurit. Furnizimi me ujë do të bëhet nga pusi (bunari) pronë e kompanisë të cilin pronari do ta bëjë me shpim të thellë, ose furnizim i ujit të nevojshëm me cisternë, me anë të pompës së ujit nëpër mjet gypsjiellësve sillet gjerë te pjesa e zgjeruar. Sistemi i ujit për zvogëlimin e pluhurit i cili lirohet gjatë procesit të therrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror, duhet të vendoset në tërë stabilimentet të cilat lirojnë pluhur dhe atë në bunkerin pranues, në gurthyesen primare me nofulla, gurthyesen sekondare dhe terciare, në të gjitha sitat vibruese, dhe në të gjithë shiritat transportues. Në sistemin për zvogëlimin e pluhurit duhet vendosur valvulet për lëshimin dhe rregullimin e sasisë së ujit në mënyrë mekanike, gjithashtu duhet të vendosën diznet të cilat e lëshojnë ujin në formë mjegulle e cila bënë ujitjen e materialit therrmues, dhe në këtë mënyrë masa e cila do të therrmohet, si dhe fraksionet ujiten ashtu që nga masa dhe fraksionet nuk mundë të lirohet pluhuri. Uji i cili shërben për mënjanimin e pluhurit duhet të rregullohet ne sasi vetëm sa të bëjë rrëzimin e grimcave të pluhurit që të mos shpërndahen ne mjedis, kjo sasi varret nga lagështia e gurit gëlqeror i cili klasifikohet dhe thermohet.

Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të therrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nëse me instalimet e sistemit të ujit nuk mund të mënjanohet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin. Kompania duhet bëjë instalimin e sistemit të depluhurimit me anë të filtrave që është sistem i avancuar për zvogëlimin e pluhurit dhe emisioneve.

Në vijim po bëjmë përshkrimin e procesit teknologjik të depluhurimit. Pluhuri i cili krijohet gjatë procesit teknologjik thithet nga stabilimentet me ndihmën e ajrit përmes gypave që do të montohen në vendet ku krijohet pluhuri. Sasia e ajrit të thithur do të

caktohet në bazë të përvojës dhe matjeve të bëra në pajimet e vendosura për shpluhrosje.

Në çdo vend për shpluhrosje do të ekzistojnë flutura rregulluese me të cilën rregullohet sasia e ajrit të thithur. Të gjithë gypat do të jenë ashtu të dimensionuar sa që shpejtësia e ajrit në ta është mjaft e madhe sa që nuk do të ketë palosje (fundërrim, ngjitje) të pluhurit në gypa. Të gjithë gypat thithës do të jenë të lidhur me gypin kryesor mbledhës të pluhurit i cili është i kyçur në filtrin OVF 350.

Në vendet lidhëse të gypave vendosen mbyllësit e gomës të cilët shërbejnë si mbyllës e njëherit edhe si izolator të ajrit.

Në filtrin e thatë prej bezi nga ajri i ndotur ndahet gati e tërë sasia e pluhurit d.m.th. bëhet filtrimi i ajrit përmes bezit filtrues. Efekti i kësaj ndarje është mbi 99 %. Koncentrimi i pluhurit në dalje nga filteri sillet nën 50 mg/m^3 e që është më pak se e lejuara 150 mg/m^3 . Filteri i bezit është i pajisur edhe me stabilimente për pastrimin e thasëve, përndryshe shtresat e pluhurit do të pengojnë krejtësisht filtrimin dhe punën e të gjitha pajimeve ose stabilimenteve. Pastrimi bëhet me ventilatorin për fryrje i cili me ndihmën e një mekanizmi largohet prej thesi në thes dhe bënë fryrjen e thasëve me lëvizjen e ajrit nën shtypje. Lëvizja e ventilatorit për fryrje prej thesit në thes dhe koha e pauzës në mes thasëve caktohet me ndihmën e releut kohor në programaturën e filterit. Ajri i pastruar nga filteri kalon përmes gypave në ventilatorin kryesor dhe prej aty në oxhak dhe del nga sistemi për shpluhërosje. Pluhuri i ndarë në filtër largohet me kërmill dhe hyn në dozatorin e transportierit pneumatik prej aty me ndihmën e ajrit të komprimuar transportohet në silos. Silosi është i pajisur me nivelues i cili regjistron nivelin maksimal në silos. Zbrazja e silosit bëhet me ndihmën e stabilimenteve për mbushje me dorë ose mekanike i cili kyçet në autocisternë. Për rrëzimin e pluhurit të shtresuar në pjesën konike të silosit bëhet me ajër të komprimuar. Kërmilli i pjerrët transportues i cili transporton pluhurin nga pjesa e poshtme e filterit ku grumbullohet pluhuri ka një hapje plotësuese e cila shërben për pastrimin e tij.

Pajimet për shpluhrosje do të përbëhen nga këto elemente:

- a. filteri OVF-350 m^2 me beze të thatë,
- b. ventilatori centrifugal,
- c. gypat, laka, reduktor, flutura rregulluese, ndarës dhe oxhaku,

- d. transporterit pneumatik,
- e. silosi,

Pajimet dhe vendet ku duhet bërë largimi i pluhurit janë këto:

1. Gjatë procesit të transportimit të inerteve deri tek nofulla
2. Thërrmuesja me nofulla
3. Thërrmuesja sekondare dhe terciare me traj dhe çekan
4. Në hinkat për derdhje të materialit
5. Në sitat vibruese
6. Në shiritat transportues

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, gjatë procesit teknologjik për thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, përpos masave të lartëcekura duhet ndërmarr edhe këto masa:

- Duhet të bëhet mirëmbajtja e rregullt e pajimeve, e posaçërisht stabilimenteve të cilat janë burim i emisioneve të pluhurit.
- Duhet të bëhet mirëmbajtja e rregullt e sistemit të instaluar për zvogëlimin e pluhurit me ujë dhe pastaj me filtër.
- Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt i thasëve filtrues të dëmtuarit të ndërrohen.
- Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve të rënda dhe konsumuesve tjerë të lëndëve të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga mjetet e punës të jetë sa më kualitativ.
- Gjithmonë duhet të bëhet spërkatja e sipërfaqeve manipuluese, rrugëve transportuese dhe fraksioneve, sidomos gjatë kohës me erëra dhe temperatura të larta.
- Duhet të jetë çdo herë në disponim auto cisterna me ujë për spërkatje.
- Kamionët të cilët bëjnë transportin e fraksioneve duhet të mbulohen me mbulesa adekuate, në kohra të thata edhe të spërkatën me ujë.
- Duhet të bëhet matja e emisioneve dhe imisioneve të pluhurit gjatë punës në punishte dhe në territorin më të gjerë, duke iu përmbajtur të gjitha masave të cekura më lartë për mbrojtjen e ajrit, me qëllim të caktimit të sasisë së përbërjes së thërrmijave të pluhurit, dhe për të krahasuar vlerat e matura më vlerat kufitare të caktuara.

6.2. Masat e marura për mbrojtjen e Tokës

Me qëllim të ruajtjes së tokës nga ndikimet negative gjatë procesit teknologjik të therrimit dhe seperimit të gurit gëlqeror, duhet ndërmarr këto masa:

- Me qëllim të mbrojtjes së tokës platoja ku janë të vendosur makinerit për therrmim dhe seperim duhet të betonohet, izolohet dhe mbulohet me pullaz që të mos u ekspozohet ndotjeve.
- Depoja dhe servisi duhet të jetë në atë mënyrë që të jetë e mbuluar, platoja duhet të jetë me bazë betoni e cila duhet të jetë e izoluar me material anti acidik, ose të sigurohen kontejner për deponim të mbeturinave të ndryshme që janë rezistent ndaj fluideve acidike.
- Duhet në mënyrë të rregullt të mirëmbahen stabilimentet operationale.
- Duhet të merrën masat e nevojshme për mos lëshuarjen e pa kontrolluar të derivateve dhe vajrave nga makinat dhe pajimet prodhuese.
- Vaji i makinave duhet të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë dhe ate ne oficinën për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ngarkuese dhe transportuese.
- Nëse detyrimisht duhet të bëhet ndërrimi i vajit në lokacionin e deponis për riciklim për shkak te avarive ne makinat ngarkuese dhe transportuese, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe duhet siguruar një pjesë nga materiali jo lëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinën që riparohet.
- Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohet në lokacionin e gurëthyesit me seperacion duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, ato metalike të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë ti shiten kompanive të licencuara.
- Mbeturinat e ngurta komunale dhe inerte të grumbullohen dhe vendosen në kontejner të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me transport vetanak apo nëpërmjet ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin e qytetit.
- Platoja dhe sipërfaqet operationale ku bëhet mirëmbajta (servisimi) i makinave transportuese dhe pajimeve prodhuese të betonohet dhe izolohet.

- Platoja dhe sipërfaqet operationale ku vendoset gjeneratori të betonohet dhe izolohet.
- Vajrat motorike dhe ato të mirëmbajtjes së pajimeve të gurëthyesit me seperacion duhet të deponohen në enë të posaçme, dhe do të u dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.
- Depoja ku deponohen vajrat dhe lubrifikantet e ndryshme si dhe vajrat e përdoruar të thurret me mur statik si dhe platoja (dysHEMEJA) të betonohet, ne te të vendoset sistemi i bartjes së ujërave gjerë në Seperator të vajrave.
- Makinat ngarkuese dhe transportuese pas kryerjes se orarit të punës të parkohen në vendin e caktuar enkas për to.

6.3. Masat për mbrojtje nga zhurma

Kompania “Renelual Tahiri” shpk me aktivitet therrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, gjatë ushtrimit te aktivitetit të tij shkakton zhurme jo edhe aq të madhe, e cila është brenda kufijve të lejuar, kjo për shkak të procesit teknologjik të lartëcekur, nga ku zhurma më e madhe vjen nga therrmojsa për imëtsimin e gurit gëlqeror. Por, duke marr parasysh se therrmojsat do te jenë të izoluar me sandvich panele zhurma do të evitohet në masë të madhe. Parcela ku kompania ushtron aktivitetin e saj, është afër rrugës regjionale qe lidhe qytetin e Prizrenit me Zhurin dhe Dragashin, prandaj zhurma që krijohet është thujse e njëjtë sikurse ajo e komunikacionit, si rrjedhojë e saj zhurma nuk paraqet ndonjë shqetësim te madh për banorët e asaj anë. Megjithatë operatori duhet te marr te gjitha masat e parapara sipas ligjit dhe akteve nen ligjore për parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës ne kuadër te normave te lejuara, duhet te kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet te cilat prodhojnë zhurmën edhe për këtë ndikim duhet te shkurtohet ne maksimum koha e mbajtjes ndezur te motorëve te mjeteve motorike, duke mirëmbajt dhe duhet kushtuar rendësi e veçante te gjitha pajisjeve te cilat emitojnë zhurme gjate procesit te punës.

6.4. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Parcelat në lokacionin në të cilën është planifikuar tw vendoset kompania “Renelual Tahiri” shpk me aktivitet therrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, siç është cekur edhe me lart është mjaft e përshtatshme për këtë veprimtari ngase gjenden afër rrugës se fshatit dhe është ne zonën e objekteve tjera industriale, prandaj dhe nuk pritet

ndikim negativ shtesë në peizazh, florë dhe faunë e lokacionit në fjalë dhe regionit në përgjithësi.

6.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Në afërsi të zonës së ku është e ndërtuar dhe duke ushtruar aktivitetin kompania në fjalë është në hapësirat e fshatit Zhur në komunan e Prizrenit. Në një distancë rreth 350 m janë shtëpit banimi mirëpo, të njëjtit nuk kanë pasur deri me tani ndonjë ankese nga banoret rreth aktivitetit të therrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror. Në një distancë më të afërt janë edhe disa aktiviteti të ngjashme, të cilat funksionojnë. Investitori ka bashkëpunim të ngushtë me komunitetin lokale të zone dhe do njofton ata me kohe për te gjitha aktivitete e mundshme që mundë të ndikojnë në vendbanim dhe në popullatën lokale gjatë këtij aktivitetit.

6.6. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore

Aksidentet e mundshme që mund të ndodhin gjatë aktiviteteve të kësaj impianti/gurthyysi mund të vlerësohen si raste të izoluara. Për të mos ardhur deri te ndonjë aksidenti eventual investitori i gurëthyesit, duhet që te merren te gjitha masat adekuate paraprakisht. Rreziku me i madhe për ndonjë aksident vjen nga energjia elektrike si edhe pajisjet për therrmim.

Për të parandaluar dhe zvogëluar rreziqet e mundshme janë marrë dhe duhet ndërmarr këto masa:

- Duhet të bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike.
- Duhet të bëhet plani i mbrojtjeve nga zjarri.
- Duhet i tërë oborri të thuret me tel gjembor,
- Të merren të gjitha masat për evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese si dhe nga pajisjet.
- Duhet të ndërtohet sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe të sigurohen aparatet me mjete kimike si dhe enët me rërë.
- Të merren të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës. Të hartohet rregullorja ku do të definohen procedurat për rastet aksidentale, të bëhet aftësimi i të punësuarve dhe të caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale.

6.7. Menaxhimi i mbeturinave

Gjatë operimit të kompanisë “Renelual Tahiri” shpk me aktivitet therrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, mbeturinat që mbesin gjatë procesit të punës duhet të mblidhen dhe të trajtohen sipas nevojës para se të hudhen në kontinjer të mbeturinave. Mbeturinat të cilat mbesin, mund të jenë mbeturinat të cilat i bënë personeli gjatë procesit të punës. Prandaj këto mbeturina duhet të adresohen në mënyrë adekuate, në mënyrë që ato mos të jenë faktorë ndotje në mjedis dhe të jenë në harmoni me praktikën e mira mjedisore dhe ligjet vendore në fuqi. Për mbetjet e mundshme të këtij aktiviteti, zgjidhja është si në vijim:

- Mbeturinat ditore nga personeli do të grumbullohen dhe do të adresohen në mënyrë adekuate në kontejnerët e ndërmarrjes komunale për mbeturina,
- Mbeturinat e mbetjeve të betonit, hekurit dhe gomës, do të merren nga kompania që është kontraktuar për këtë.

7. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

7.1. Monitorimi

Në bazë të gjendjes faktike në terren, pasi që ky aktivitet nuk paraqet trysni mjedisore, monitorim i detyrueshëm dhe permanent i treguesve mjedisor janë të domosdoshëm. Produktet dhe ndikimet në mjedis do të kontrollohen në mënyrë të rregullt dhe për çdo rast duhen të merren masat e nevojshme komform ligjeve dhe të njoftohen organet kompetent.

7.2. Raportimi

Raportimi do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor, përkatësisht Lejen Mjedisore të lëshuara nga MMPHI.

8. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT

Pas përfundimit të jetë gjatësisë së projektit, e kjo varet nga pronari se sa do të vazhdojë me këtë projekt. Karriera e hapur pas përfundimit të shfrytëzimit përfundimtar do të krijohet një shesh në të cilën është e domosdoshme të bëhet rikultivimi i etazheve në mardhënje me ambientin rrethues. Gjendja e terrenit mundëson që sipërfaqja e

karrierës të rikultivohet me bimë të cilat i përshtatën kushteve mjedisore-klimatike që përmirëson peizazhin, pamjen vizuale, pengon procesin e erozionit dhe arrin efektet e dëshirueshme mjedisore për brezat e ardhshëm. Pas përfundimit të jetë gjatësisë së projektit e kjo varet nga interesi i kompanisë. Pas këtij afati pajimet duhet të çmontohen e të vendosen në një lokalitet tjetër apo në bazë të leverdis së kompanisë të shitën si material i vjetruar. Bazamentet nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi tregjionale. Rikultivimi si proces mjedisor realizohet në marëdhënje në tri faza.

- Faza teknike
- Faza agro-teknike dhe
- Faza biologjike

9.1. Faza e teknike e rikultivimit

Faza e teknike e rikultivimit përfshin aktivitetet e përgatitjes së karrierës me qëllim të rregullimit të terrenit, gjegjësisht mbushjes, shtrirjes së sterilit në sipërfaqen e karrierës e cila duhet të jetë e përshtatshme për shtrirjen e humusit.

9.2 Faza e rikultivimit agro-teknik

Masat agro-teknike të cilat duhet të kryhen janë:

Shpërndarja e pjesës humusore me trashësi adekuate 50 cm, në tërë sipërfaqen e përgatitur për rikultivim. Me qëllim të rritjes së stabiliteti dhe përfitimit të kompaktësisë duhet të bëhet aktiviteti i ngjeshjes. Pas kryerjes së këtij operacioni duhet bërë hapja e kanaleve, apo birave për mbjelljen e fidanëve. Gjerësia dhe thellësia e birave duhet të jetë e gjerë sa është shtrirja e lirë e sistemit rrënjësor të bimës. Në gropat e hapura duhet bërë plehrimin me qëllim që fidanët në procesin fillestar të vegjetacionit të kenë materie ushqyese të mjaftueshme për zhvillim. Mbjellja e fidanëve duhet bërë në sezonin e vjeshtës kur sasia e lagështisë është më e madhe me qëllim që bima të ketë fillim të suksesshëm të vegjetacionit në stinën e pranverës.

Investitori obligohet që fidanët të cilat mbillen të kenë çertifikatën shëndetësore për gjendjen e tyre nga prodhuesi i licencuar. Procesi i mbjelljes duhet bërë duke hequr pjesët e rrënjëve dhe pjesët tjera të dëmtuara. Para mbjelljes së fidanëve, rrënjët e tyre duhet të zhyten në solucion të freskët prej argjile duke bërë një kombinim i cili

shërben si ushqim fillestar për bimën. Përgatitja e kushteve në këtë mënyrë, bima është e gatshme të mbillet.

Dimensionet e gropave për mbjelljen e bimës duhet të jetë 40 x 40 cm

Distanca e ndërmjet bimëve në rendë duhet të jetë 2 m.

Distanca në mes rendeve duhet të jetë 3 m.

Drejtimi i mbjelljes së rendeve duhet të jetë VJ-PL

$$Nrf = S / a \times b$$

Nrf - numri i fidanëve

S -Sipërfaqja (m^2)


a -distanca e fidanëve (m)


b - distanca e filaneve në mes rendeve (m)

9.3 Faza e rekultivimit biologjikë

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave ekologjike dhe përshtatshmërisë së ambientit bimët të cilat i rekomandohet investitorit të mbillet është Bredhi i zi, është bimë halore gjethëmbajtëse që i përshtatet kushteve klimatike të rajonit, në këtë lokacion. Mbjellja e këtij druri do të përmirësoj pamjen vizuale, peizazhin, freskon ambientin, do të ketë pamje me të bukur, dhe shton sipërfaqen e pyllëzuar që është e mangët në këtë zonë. Bredhi i zi është bimë rezistuese ndaj ndryshimeve klimatike temperaturave ekstreme dhe është rezistues ndaj dëmtuesve biologjik. Edhe pse janë propozuar këto bimë, duhet të bëhet konsultimi me autoritetet komunale dhe te Ministrisë së bujqësisë dhe pylltarisë. Investitorit i rekomandohet që pas mbjelljes së fidanëve të përkujdeset për rritjen e fidanëve të mbjellura.

Përgatitja dhe mbjellja e fidaneve shihet ne figurat e më poshtme.





10. Kontrolli i emisioneve pas shfrytëzimit

Me përfundimin e aktivitetit minerarë për thërrmim dhe seperimin të gurit gëlqeror dhe aktiviteteve tjera teknologjike, respektivisht pas përfundimit të jetës së minierës dhe rehabilitimit të ngastrave për qëllime tjera, nuk është e nevojshme dhe nuk parashihet monitorimi i ajrit, ujit dhe tokës apo ndikimet tjera në mjedis për shkak të shfrytëzimit përfundimtarë të minierës. Kompania shfrytëzuese, ka për detyrë të bëjë monitorimin e sipërfaqeve të rekultivuara, posaçërisht pjesës së pyllëzuar për një kohë të caktuar.

11. KONKLUSIONE

Duke analizuar studimin e bërë për identifikimin e ndikimeve të mundshme, masave për parandalimin e ndikimeve, intervistave e opinioneve, aktivitetit që do të zhvillohet si dhe duke iu referuar dokumenteve ekzistuese mund të konkludojmë si në vijim: Kompania “Renelual Tahiri” shpk me aktivitet thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, në zonën kadastrale Zhur komuna e Prizrenit është në interes:

- Të vetë investitorit për të përmirësuar kushtet e punës dhe për të rritur kapacitetin e prodhimit të fraksioneve të rëres;
- Në interes të ekonomisë së vendit, sepse gjeneron të hyra dhe komunitetit i ofron produkte cilësore të rëres.
- Në interes të banorëve të tjerë lokal, sepse do të ofrohen mundësi punësimi dhe poashtu një ambient mirë të menaxhuar.

Në rast se kompania “Renelual Tahiri” shpk me aktivitet thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, mirëmbahet në mënyrë profesionale dhe me standarde siç parashihet të mirëmbahet dhe me respektimin e plotë të masave të dhëna në këtë raport, si dhe

me bashkëpunimin e plotë me autoritetet përgjegjëse, ky aktivitet konsiderohet krejtësisht i pranueshëm si në aspektin mjedisor, po ashtu edhe në atë social dhe ekonomik. Duke u bazuar në natyrën e aktivitetit të tij, vendndodhjen, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet në mjedisin lokal janë minimale dhe tërësisht të kontrollueshme.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së investitorit-aplikuesit “Renelual Tahiri” Sh.P.K me seli në Prizren.

11. Shtojcat

Bashkëngjitur këtij raporti gjeni:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit,
- Te dhënat për biznesin,
- Certifikatat e pronësë,
- Kopjet e planit,
- Situacioni i terrenit,
- Pëlqimi/njoftimi i komunës,
- Skica e procesit teknologjik